URDHËR
Nr.84, datë 9.9.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT TË ALOKIMIT TË SLOTEVE NË AEROPORTE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 63 të ligjit nr.10 040 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për organizimin e procesit të alokimit të sloteve në aeroporte", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Transportit Ajror dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tij nga operatorët.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi